

## PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Sherbime

### **PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROCEDURËS: SHËRBIMI I DEKORIT TË FESTAVE TË FUNDVITIT**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

PCV 45451000-3 Dekorime

**VLERA E FONDIT LIMIT: 4,100,667 (katërmilion e njëqindmijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë, pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Kavaje ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

#### **I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit sipas shtojcës nr.10
- b. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen me Nenin 76 “Kriteret detyruese për skualifikim” Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të Nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik

*Neni 82, i LPP “1. Bashke me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vertetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.*

*Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”,*

#### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1.** Kopje të deklaratave të xhiros vjetore të viteve 2021, 2022 dhe 2023, lëshuar nga Administrata Tatimore, me vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së parashikuar të kontratës. Në zbatim të nenit 43, pika 3, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 kjo kërkesë do të konsiderohet. Në zbatim të nenit 43, pika 3, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar mësipër. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Sipas nenit 43 pka 2/c të VKM nr.285 datë 19.05.2021 ku citohet ” 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”.”

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*

**2.2.2.** Kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve 2021, 2022 dhe 2023 të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve neni 41, pika ”c”, të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar. Në zbatim të nenit 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

*(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).*

**2.2.3** Operatorët ekonomikë duhet të kenë shlyer të gjitha taksat vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2023, ku te perfshihet kesti per periudhen perkatese te maturuar, sipas përcaktimeve të Ligjit nr.

Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit. Për të përmbushur kërkesën e mësipërme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues i përcaktuar mesipër duhet të paraqitet pranë Autoritetit Kontraktor para publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Ligjin nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar.

## 2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

**2.3.1.** Për të provuar përvojën e mëparshme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% e fondit limit të kësaj kontrate. Për të provuar përvojën e mëparshme, duhet që:

a. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik si dëshmi për përvojën e mëparshme të paraqiten vërtetim i realizimit me sukses dhe faturën tatimore të shitjes të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet.

b. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat si dëshmi për përvojën e mëparshme të paraqiten fatura tatimore të shitjes të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

**2.3.2.** Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar të paktën 7 (shtatë) punonjës (përfshirë në këtë numër punëtorë, manovratorë, stafi teknik) ku për periudhën Korrik 2024 – Shtator 2024, të vërtetuar me:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën Korrik 2024 – Shtator 2024.
- Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Qershor Korrik 2024 – Shtator 2024

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ky kusht plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementet konkret) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim

**Argumentim:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41 pika 4/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin e nevojshme (fuqi punëtorë) për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

**2.3.3.** Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi për 1(një) autovinc me kosh me krah  $\geq 12$ metra dhe 1(një) kamioncine me kapacitet mbajtës  $\geq 3$ ton, që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion për realizimin e shërbimeve objekt i kontratës.

Për mjetet me rrota që shënohen në regjistra publike duhet të paraqitet leja e qarkullimit, çertifikata e pronësisë, çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, taksat vjetore, leja e transportit për mjetet me kapacitet mbajtës  $\geq 1.5$ ton dhe foto perkatëse.

Për mjetet me rrota që shënohen në regjistra publike që merren me qira të paraqitet kontrata noteriale e qirasë e vlefshme gjatë gjithë afatit të realizimit të kontratës objekt prokurimi. Bashkangjitur kontratës së qirase duhet të paraqitet leja e qarkullimit, çertifikata e pronësisë, çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, taksat vjetore, leja e transportit dhe foto perkatëse.

Për mjetet dhe pajisjet që nuk pajisen me leje qarkullimi të paraqitet dokument i vlefshëm që vërteton pronësinë apo marrjen me qira të tij.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4 ç), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës, si dhe bazuar në ligjit nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”.

**2.3.4.** Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, operatorët ekonomikë duhet të kenë stafin e tyre teknik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të kontratës. Për të përmbushur këtë kapacitet operatorët ekonomikë duhet të paraqesin pranë Autoritetit Kontraktor kontratë të vlefshme pune për minimumi 3(tre) elektrikistë të certifikuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial / ekuivalente apo nga subjekte juridike private të akredituara në Republikën e Shqipërisë për çertifikimin e punonjësve. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4 b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës sipas nenit 44 pika 1 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

**2.3.5.** Operatori ekonomik ditën e zhvillimit të tenderit duhet të paraqesë fizikisht mostrat për artikujt sipas zerave (1,2,3,4,5,6,7,10,12,15) të preventivit

- Mostra duhet të paraqiten ditën dhe orën e zhvillimit të procedurës së prokurimit në ambjentet e AK.
- Cdo mostër e paraqitur pas orarit të përcaktuar për hapjen e procedurës nuk do të pranohet.

- Mostra duhet të përputhet me cilësimet e dhëna në specifikimet teknike. Nëse mostra nuk është sipas specifikimeve OE do të skualifikohet.

Mosparaqitja e mostrave është kusht për s'kualifikim

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 6 , të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson tënevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

**2.3.6.** Operatorët ekonomikë, për të vërtetuar se punët, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, duhet të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, I akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë të jenë të vlefshme, e që kanë lidhje me objektin e kontratës dhe në rastin kur ai nuk është prodhues të paraqesë certifikatën përkatëse të prodhuesit/distributorit të autorizuar të mallrave objekt prokurimi. Konkretisht:

1. ISO 9001-2015 (Standard për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë)/ekuivalente dhe e vlefshme.
2. ISO 45001:2018 – (Standard për Sistemin e Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë)/ekuivalente dhe e vlefshme

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”. Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët të kryejnë punimet dhe realizojnë objektin e kontratës me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, të mjedisit dhe shëndetit të sigurisë në punë janë standarde që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë do të pranohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit përgjegjës për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës, bazuar dhe në nenin 44, pika 1 , të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,

**2.3.7.** Fusha e veprimtarisë së operatorit ekonomik ofertues në faqen zyrtare të Qendrës Kombëtare të Biznesit duhet të përputhet me objektin e prokurimit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”. Për vet natyrën e veçantë të objektit që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët të realizojnë objektin e kontratës me standardet e kërkuara të cilësisë.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**